

Për:	Operatorë Ekonomik: GJEO-PROJEKT SHPK me adresë në Rahovec Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	14.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **13.05.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **GJEO-PROJEKT SHPK** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **GJEO-PROJEKT SHPK** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **12.04.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **GJEO-PROJEKT SHPK** me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DIGJITALIZIMI I DOKUMENTACIONIT KADASTRAL – RIRREGULLIMI I VEKTORIT NË KOMUNËN E RAHOVECIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-24-3443-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-24-011-2-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **12.04.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **13.05.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR:

Ne kuader të dosjes së tenderit keni kerkuar si vijon: OE të dëshmoj me dokument relevant që është i licencuar apo ka marrëveshje me një OE Institut të licencuar në vendin amë për ofrimin e trajnimeve në QGIS.

Te nderuar, punët të cilët janë planifikuar të kryhen për projektin në fjalë punët mund të kryhen në një gamë të gjërë të softuereve GIS dhe CAD siç janë: Global Mapper, ArcGIS, QGIS, MapInfo, 3D survey, AutoCad etj.

Mirpo për arsye favorizimi ju si kontraktor në këtë projekt keni vendosur që të favorizoni vetëm operatorët ekonomik të cilët mund të jenë të certifikuar me softuer QGIS ose të kenë marrëveshje me ndonjë institut ose OE i cili ofron shërbimet për softuerin QGIS.

Konsiderojmë që eliminimi i të gjitha softuereve tjera për përpunimin e të dhënave GIS dhe kompanive të cilët janë të certifikuar me GIS softueret siç janë: Global Mapper, ArcGIS, etj, është shkelje ligjore dhe kërkojmë nga ju që të anulohet ky kriter diskriminues ndaj OE të cilët nuk kanë certifikatë për softuerin QGIS por mund të kenë certifikatë dhe marrëveshje të drejtëpërdrejta me prodhuesit e softuereve tjera të GIS-it.

Konsiderojmë që edhe kriteri që duhet të kemi vetëm marrëveshje me kompanit ose institute vendore është shkelje ligjore dhe eliminim i drejtëpërdrejte i OE nga ky aktivitet i prokurimit.

Kërkojmë nga AK, të e kthen këtë projekt në rrugë ligjore dhe të mos marrëveshje me eliminime të OE në formë jo ligjore.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR:

Pretendimi ankimor i Operatori Ekonomik nuk qëndron!

Kërkesa e vendosur nga ne në Njoftim për Kontratë dhe Dosjen e tenderit është si më poshtë:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 5: OE te dëshmoj me dokument relevant qe është i licencuar apo ka marrëveshje me një OE Institut te licencuar ne vendin ame per ofrimin e trajnimeve ne QGIS;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 5: Operatori Ekonomik duhet të paraqes dokumentin e noterizuar apo marrëveshjen e bashkëpunimit te vulosur dhe nënshkruar;

Arsyeja pse AK mendon se ky pretendim i këtij OE është i pabazuar do të sqarohet në vazhdim. Sipas LPP-së, AK-të janë të detyruara që gjatë çdo zhvillimi të procedurave të prokurimit të kenë parasysh dhe të respektojnë nenin 1, 6, 7, 10, 27, dhe 28.

AK sipas dosjes së tenderit shihet se për realizimin e projektit në fjalë, ka përzgjedhur softwaren apo programin QGIS i cili është lehtë i qasshëm nga çdo kush dhe se i njëjti është pa pagesë. Me vet faktin që instalimi i tij në pajisjet kompjuterike të Komunës është pa pagesë dhe nuk ka nevojë as për licenca apo mirëmbajtje të kushtueshme gjatë përdorimit të tij, tregon se AK ka respektuar nenin 1 të LPP-së duke zbatuar kërkesa dhe nevoja që tregojnë se buxheti i Komunës po shfrytëzohet në mënyrën më ekonomike të mundshme.

AK ka respektua edhe nenin 6 të LPP-së gjatë vendosjes së kriterit për këtë software pasi që i njëjti është i lehtë për përdorim, është i pa kushtueshëm si dhe lejon një aplikim të lehtë nga stafi apo nga çdo kush tjetër që tregon qartë për aplikim efikas dhe efektiv të shfrytëzimit të parasë publike nga AK.

Edhe kërkesa që OE duhet të dëshmoj me dokument relevant qe është i licencuar apo ka marrëveshje me një OE Institut te licencuar ne vendin ame per ofrimin e trajnimeve ne QGIS tregon se AK ka respektua nenin 7 të LPP-së duke mos krijuar asnjë kufizim teknik, ligjor apo gjeografik. Mundësia e angazhimit të ndonjë kompani të licencuar nga secili vend që mund të përzgjedh OE me kusht që kompania e tillë të jetë e licencuar dhe kjo të bëhet me marrëveshje e që tregon për respektim të plotë të nenit 7 të LPP-së.

Transparenca gjithashtu është respektua në përputhje me nenin 10 të LPP-së pasi të gjitha informatat e nevojshme janë dhënë për OE në të njëjtën kohë pa favorizuar apo diskriminuar asnjërin nga OE të interesuar.

Neni 27 dhe 28 i LPP-së është respektua me rastin vendosjeje së kushteve dhe kriterëve që OE duhet të plotësojnë dhe në të njëjtat përpos që ofrojnë mundësi për çdo tenderues, ato promovojnë transparencën dhe mundësin e hapur të konkurrencës për çdo të interesuar.

Pra përzgjedhja e këtij softueri është kryesisht për shkak të asaj që është i pa kushtueshëm, nuk ka nevojë për licenca të përsëritura që zakonisht kushtojnë shumë, instalohet pa pagesë nëpër pajisjet kompjuterike të Komunës, është i lehtë për përdorim, lejon shumë mundësi pasi është shumë ma efikas për te ruajtur shënimet dhe për ti përpunuar ato. Ka mënyra shumë ma shumë se programet tjera siç janë AutoCad, MapInfo etj.

Vlen të thuhet edhe kjo se shumica e Komunave në Kosovë e përdorin softverin e tillë e që tregon qartë për ekonomikitetin dhe efikasitetin e këtij programi. Fundja kjo është kërkesë nga njësia kërkuese e cila me arsye ka vendosur që të përdor këtë lloj softvari për implementim të projektit në fjalë.

Sipas LPP-së dhe Regurrores: 001/2022, AK është përgjegjëse dhe mbanë të drejtën ekskluzive për përcaktimin e nevojave të veta me kusht që paraprakisht të respektohen dispozitat e ligjit siç edhe kemi vepruar. Pra krejt ky sqarim tregon se AK ka venpruar drejt kur ka vendosur në përzgjedhjen e këtij softveri dhe se pretendimi i OE është i pabazuar duke u aplikuar në këtë fazë vetëm sa për ta prolonguar procesin dhe për të vonuar projektin për më shumë sqarime shihni tabelën e më poshtme e cila e arsyeton ekonomikisht përzgjedhjen e softverit QGIS:

Nr.	Emri i softuerit	Cmimi/vit	Cmimi/ periudha 10 vjeçare	Burimi i informac ionit
1	QGIS	0	0	https://www.selecthub.com/p/facility-management-software/qgis/
2	ARCIGIS PROFFESIONAL ADVANCED	3,800.00€	38,000.00€	https://www.trustradius.com/products/arcgis/pricing
3	GLOBAL MAPPER PRO	4,348.00€	43,480.00€	https://www.bluemarblegeo.com/purchase-global-mapper/
4	3DSURVEY	3,000.00€	30,000.00€	https://store.3dsurvey.si/pricing
5	MAPINFO PRO	1,645.00€	16,450.00€	https://store.pbinsight.com/store/pitneybo/en_US/pd/ThemeID.5000138300/productID.5811457000/categoryID.43348500/parentCategoryID
6	AUTOCAD CIVIL 3D	2,780.00€	27,800.00€	https://www.autodesk.com/products/civil-3d/overview?term=1-YEAR&tab=subscription

Nga tabela po shihet se vetëm Softveri QGIS nuk krijon vartësi financiare për AK-në ndërsa softvaret tjera të përmendura nga OE ankues e rrisin shumë koston e aplikimit të tyre që për AK nuk janë të leverdishme.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit